URDHËR
Nr. 290, datë 27.12.2023

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe në zbatim të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; të nenit 12, pika 1 dhe nenit 13, germa "b", të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe të nenit 7, pika 2, germa "c", të rregullores "Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar, në mungesë të Kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të Kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, gjyqtares Mimoza Tasi, për periudhën 3.1.2024–5.1.2024. Kjo kompetencë nuk mund të nëndelegohet.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet gjyqtarja Mimoza Tasi dhe të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT
Sokol Çomo